



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

---

Numri i lëndës: 2019:144008  
Datë: 12.02.2021  
Numri i dokumentit: 01503886

**C.nr. 50/16**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN/DEGA NË VITI - Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari Arben Xheladini, në çështjen kontestimore të paditësit, N.N nga fshati Mogillë, Komuna e Klllokotit, të cilin, sipas autorizimit e përfaqëson, Ferid Shabani, avokat me seli të zyres në Gjilan, kundër të paditurës KS “SIGAL” me seli në Prishtinë, rr. “Ukshin Hoti”, nr. 19, Pejton kati 4, e përfaqësuar nga Sokol Dardha, Jurist nga Prishtina, me objekt kontesti kompensimi i dëmit material, vlera e kontestit 2, 000 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 01.02.2021, jashtë seance, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.** Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit N.N nga fshati Mogillë, Komuna e Klllokotit, kundër të paditurës KS “SIGAL” me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura t’ia kompensojë paditësit shumën prej 2, 000 Euro në emër të dëmit material në automjetin Golf, me targa GL-331-27 si pasojë e aksidentit 02.12.2010, me kamatë ligjore prej 12 %, e llogaritur nga data 15.10.2010, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

**II.** Secila palë i bartë shenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Me datë 14.02.2016, paditësi N.N, ka paraqitur padi kundër të paditurës KS “SIGAL” me seli në Prishtinë, më të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material në shumë prej 2, 000 Euro, për veturen e tij Golf, me targa GL-331-27 si pasojë e aksidentit 02.12.2010, me kamatë ligjore prej 12 %.

Përfaqësuesi i paditësit, në seancën përgatitore, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar, dhe e paditura të detyrohet në kompensimin e shumës prej 2, 000 Euro, për veturen e paditësit e cila ishte dëmtuar në aksidentin e datës 02.10.2010. Tutje, ka theksuar se paditësi me kohë ka paraqitur kërkesë për kompensim të e paditura, e cila asnjëherë nuk ia ka dorëzuar vendimin, me të cilin, ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit, ashtu që, paditësi në momentin e parë që e ka siguruar Vendimin e gjykatës lidhur me përgjegjësinë e shkaktarit të

aksidentit, e ka dorëzuar te e paditura, e cila pastaj kërkesën e paditësit për kompensim të dëmit e ka refuzuar me arsyetimin se është e parashkruar. Lidhur me pretendimin për parashkrim të kërkesës, përfaqësuesi i paditësit ka argumentuar se afati i parashkrimit nuk ka ecur për faktin se kërkesa e paditësit e ka pasur statusin e lëndës së pa kompletuar respektivisht të kushtëzuar me vendim të gjykatës.

Përfaqësuesi i të paditurës, në të gjitha fazat e procedurës, e ka kundërshtuar kërkesën e paditësit duke theksuar se është e parashkruar për shkak se nga data e aksidentit e deri në datën e dorëzimit të padisë në gjykatë, ka kaluar si afati subjektiv e po ashtu edhe afati objektiv i parashkrimit. Tutje, ka theksuar se në këtë rast duhet të zbatohet afati subjektiv i parashkrimit për shkak se paditësi ka qenë në dijeni për dëmin e shkaktuar dhe për personin që e ka shkaktuar dëmin.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Raporti i Policisë CNR 3004-635-10, i datës 02.10.2010 dhe skica nga vendi i ngjarjes, Libreza e qarkullimit, patent shoferi, polisa e sigurimit për paditësin, numri i polisës së shkaktarit të aksidentit nr.2673961, leternjoftimi i paditësit, aktvendimi i Gjykatës Komonale për Kundërvajtje në Gjilan Regj.nr.15124/10, Aktekspertimi i dëmit i dt.15.10.2010, 16 foto mbi dëmtimin e automjetit të bëra nga e paditura, deklaratat e të dëmtuarit e dhënë te e paditura, kërkesa standarde e të paditurës e bërë nga paditësi, njoftimi i të paditurës për plotësimin e dokumentacionit i datës 15.10.2019, Vendimi i të paditurës i datës 11.12.2014, Vendimi i të paditurës i datës 19.06.2015, Njoftimi i të autorizuarit të paditësit i datës 05.10.2015, Ankesa e paditësit e datës 05.10.2015, Vendimi i të paditurës i datës 12.10.2015, Kërkesa e paditësit e datës 08.10.2016.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike:

Me datë 02.10.2010, paditësi N.N me veturen e tij Golf me targa GL-331-27 i identifikuar si njësia “B” ishte përfshirë në një aksident të komunikacionit me njësinë “A”, dhe për këtë rasti ishte referuar në Gjykatë. Me datë 15.10.2010, paditësi e kishte plotësuar kërkesën standarde për kompensim të dëmit te e paditura, e cila, me njoftimin e datës 15.10.2010, kishte kërkuar, nga tani paditësi, dokumente shtesë. Me vendimin e datës 11.12.2014, Komisioni i shkallës së parë i të paditës, e kishte refuzuar kërkesën e paditësit me arsyetimin se i mungon baza juridike pasi që nuk kishte paraqitur prova për të vërtetuar se nuk është shkaktar i aksidentit. Me datë 09.06.2015, paditësi e kishte dorëzuar Aktvendimin e Gjykatës së atëhershme Komonale për Kundërvajtje në Gjilan, Regj.nr. 15124/10, të datës 24.11.2011, me të cilin vozitësi i njësisë “A” ishte shpallur përgjegjës për aksidentin e komunikacionit të datës 02.10.2010, dhe lidhur me këtë, me datë 19.06.2015 e paditura e kishte refuzuar kërkesën për kompensim të dëmit material, me arsyetimin se tani kjo kërkesë është e parashkruar. Përfundimisht, me vendimin e datës 12.10.2015, Komisioni i shkallës së dytë për shqyrtim të ankesave, e kishte refuzuar ankesën e tani paditësit dhe e kishte konfirmuar vendimin e shkallës së parë. Pas kësaj, me padinë e datës 14.02.2016, paditësi e kishte filluar procedurën kontestimore kundër të paditës.

Gjatë shqyrtimit kryesor, çështje kontestuese për palët ndërgjyqëse ishte fakti nëse kërkesa e paditësit ishte e parashkruar, ndërsa asnjë pretendim tjetër sa i përket aksidentit të ndodhur dhe provave të administruara, nuk ishin kontestuese.

Për këtë qëllim, gjykata, fillimisht e vlerësoi këtë pretendim dhe, erdhi në përfundim se kërkesëpapia e paditësit është e parashkruar, të cilën edhe e refuzoi si të pa bazuar.

Paditësi kishte pësuar aksident me datë 02.10.2010, ndërsa padinë në gjykatë e ka dorëzuar me datë 14.02.2016, fakt ky i vërtetuar me raportin e policisë të datës 02.10.2010, dhe me një krahasim të datës së ndodhjes së aksidentit me datën e dorëzimit të padisë, vërtetohet se padia është dorëzuar pas pesë viteve nga data e aksidentit.

Meqenëse raporti juridik është krijuar në vitin 2010, si ligj të zbatueshëm material, gjykata e ka aplikuar Ligjin Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978, të cilit do t'i referohet me shkurtesen "LMD".

Me nenin 376.1 të LMD është përcaktuar afati i parashkrimit të kërkesave për dëmin e shkaktuar, sipas të cilit: "Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe personin që e ka bërë dëmin", ndërsa në par. 2 ka përcaktuar se kërkesa parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi.

Sipas nenin 376.1 të LMD, afati tre vjeçar kë të bëjë me rastet kur i dëmtuari e kupton se i është shkaktuar dëm, e po ashtu ka njohuri edhe për personin që ia ka shkaktuar dëmin, i cili njihet si afat subjektiv, ndërsa afati pesë vjeçar në par. 2 njihet si afat objektiv ashtu që pas kalimit të këtij afati, humb edhe e drejta e kërkesës.

Faktin e shkaktimit të dëmit, paditësi e ka kuptuar në momentin e aksidentit – datë 02.10.2010, e gjithashtu, ka pasur njohuri rreth identitetit të personit me të cilin ka pasur aksident. Meqenëse në këto raste, përgjegjësia e shkaktarit të dëmit në aksident varet nga vendimi gjyqësor, kushti i dytë që ka të bëjë me njohurinë se kush ka qenë personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit, është plotësuar më së voni me datë 15.02.2012, kohë kur edhe aktvendimi Regj.nr. 15124/10, i datës 24.11.2011, është bërë i ekzekutueshëm.

Duke qenë se, dëmi është shkaktuar me datë 01.10.2010 dhe paditësi, më së voni, me datë 15.02.2012 e ka krijuar bazën juridike për të mbështetur kërkesën e tij për kompensim të dëmit ndërsa, padinë e ka dorëzuar në gjykatë me datë 14.02.2016, kërkesëpapia e tij është parashkruar sipas afatit subjektiv të përcaktuar në nenin 376.1 të LMD, për shkak se padinë e ka dorëzuar pas kalimit të tri viteve. Paditësi, si palë e interesuar, ka mundur në çdo kohë ta siguroj vendimin e gjykatës me të cilin ishte vendosur se kush ka qenë përgjegjës për aksidentin e datës 02.10.2010.

Sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit, gjykata i gjeti si të pa bazuara, për shkak se fakti i paraqitjes së kërkesës për kompensim të dëmit, vendimi për plotësim të dokumentacionit dhe pretendimi se kërkesa e paditësit të e paditura e ka pasur statusin e lëndës

në proces, është i pa ndikim në ecjen e afateve të parashkrimit, për arsye se sipas nenit 388 të LMD “parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”.

Gjykata, administroi edhe prova të tjera materiale, por të njëjtat nuk i arsyetoi, pasi që ishin pa ndikim në vendosjen e çështjes. Ndërsa, pas administrimit të provave materiale, me qëllim zbatimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, kërkesën e paditësit për sigurimin e provës me ekspertizë, e ka refuzuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës u vendos sipas neni 450 të LPK, ndërsa e paditura nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr. 50/16, datë 01.02.2021**

**Gjyqtari,**

Arben Xheladini

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 15 ditëve, i llogaritur pas ditës së pranimit të aktgjykimit. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.